



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.8/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Afijete Sada - Glllogjani, Faton Ademi, Kymete Kicaj, Milena Đerić, Zyhdi Haziri, Burim Ademi, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Muhamed Aliu Mergjollar, kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, paraqitur ndaj Vendimit të KQZ-së, me Nr.224-2021, për shkak të mos certifikimit për pjesëmarrjen në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur me 25.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli Anr.8/2021 i datës 23.01.2021, i parashtruar nga Muhamet Aliu Mergjollar, kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, paraqitur ndaj Vendimit të KQZ-së, me Nr. 224-2021, për shkak të mos certifikimit si kandidat në listën e subjektit politik PREBK, për pjesëmarrjen në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datën 14 Shkurt 2021.

A r s y e t i m

Me datën 23.01.2021 PZAP-i ka pranuar një apel Muhamet Aliu Mergjollar, i kandiduar me nr.2 pranë listës të subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, në të cilin pretendon se iu është bërë e padrejtë moscertifikimi i tij, në bazë të vendimit të KQZ-së, të bazuar në rekomandimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në vazhdim pretendon se dënimin që kishte iu është shlyer dhe mendon se është i pastër me të cilën ka bashkangjitur dokument shtesë.

PZAP-i me datën 23.01.2021 ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kërkesën për përgjigje në ankesë. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike ZRPPC-KQZ ka dërguar përgjigjen në ankesë më datën 24.01.2021, në të cilën theksohet se subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës-PREBK, parti parlamentare, që garon për ulëset e garantuara për komunitetin rom të Kosovës, ka dorëzuar dokumentacionin për certifikim të 33 kandidatëve për deputete më datën 14.01.2021. Pas kontrollimit të dokumentacionit, në kuadër të obligimeve ligjore, theksohet se Zyra ka bërë verifikimin e dokumentacionit sipas listës së mësipërme si dhe kualifikimin sipas nenit 29 të Ligjit të Zgjedhjeve të Përgjithshme. Më tutje në përgjigje thuhet se në kuadër të verifikimeve, Zyra me datë 18.01.2021, i ka dërguar shkresë Këshillit Gjyqësor të Kosovës për të pranuar listën e kandidatëve që bie ndesh me gërmat a,o, dhe q të nenit 29 LZP. Më datë 20.01.2021, Zyra për certifikim, nga KGJK ka pranuar informatën që pesë persona nga lista e PREBK njëri ndër ta edhe Muhamet ALi Mergjollar, janë identifikuar që kanë aktgjykim të formës së prerë. Në vazhdim të përgjigjes theksohet se Zyra e ka njoftuar zyrtarisht subjektin politik PREBK për informacionin e pranuar, dhe subjekti politik PREBK ka zëvendësuar katër nga pesë kandidatët duke sjellë listën e re të kandidatëve. ZRPPC më datë 22.01.2021, ka rekomanduar certifikimin e 32 kandidatëve nga Partia Rome e Bashkuar e Kosovës- PRBK, sipas listës së pranuar nga subjekti politik PREBK.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj apelin, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoj lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ-ja, lidhur me refuzimin për certifikimin e tij nga gara e listës së kandidatëve për deputet, ju është bërë e padrejtë pasi që iu është shlyer dënimi nga evidenca e të dënuarve. Paneli vlerëson se pretendimet e parashtruesit të apelit janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, sepse neni 29 par.1 pika q) i LZP-së, përcakton se cilido person, emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve, është i përshtatshëm për certifikim, përveç nëse personi është shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit, siç edhe është në rastin konkret ngase parashtruesi i apelit me Aktgjykimin e plotfuqishëm P.nr 112/2018 i formës se prerë me datë 26.06.2019 me të cilin është shpallur fajtor për vepër penale.

Mbi këtë bazë, Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit Nr. 224-2021 të datës 22.01.2021 drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 29 par. 1 pika q) të LZP-së, pasi që i njëjti është shpallur fajtor për vepër penale me aktgjykim përfundimtar në tri (3) vitet e fundit, sipas Aktgjykimit të plotfuqishëm P.nr112/2018 i formës se prerë me date 26.06.2019 dhe me këtë vendim është certifikuar lista me 32 kandidatë nga PREBK e rekomanduar nga ZRPPC me të cilën i njëjti nuk është i përfshirë në listën e rekomanduar dhe çdo pretendim në apel mbi këtë bazë është i paqëndrueshëm.


Fakti se parashtruesi i apelit pretendon se dënimi i shqiptuar është shlyer nga evidenca e të dënuarve, për Panelin rrethanat e tilla nuk krijojnë mundësi për përshtatshmërinë e kandidatit bazuar në kufizimet e përcaktuara në nenin 29 par 1 pika q) të LZP-së, nga se kjo dispozite ka përcaktuar tri kritere, që të jetë shpallur fajtor për vepër penale, që të jetë dënuar në tri vitet e fundit dhe që vendimi të jetë i formës se prerë, për pasojë në rastin konkret që të tri këto kritere ligjore plotësohen dhe shlyerja nga evidenca e të dënuarve ka efekt për të drejtat që janë humbur si pasojë e dënimit penal, ndërsa sipas LPZ-së, për tu certifikuar kandidati për deputet duhet shikuar vetëm se a plotësohen këto tri kritere ligjore nga neni 29.1. pika q) të LZP-së.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika b) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në pajtim me nenin 115.1 lidhur me nenin 118.1, 118.5 të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 8/2021 më datën 25.01.2021.

Kryesues i Panelit
Brustem Thaqi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.